

Besim MORINA

## KISHA KATOLIKE PËRBALLË PUSHTIMEVE OSMANE (GJATË SHEK. XIV-XV) NË TERRITORIN E KOSOVËS SË SOTME

Territori i Kosovës së sotme, si pjesë e pandarë e Arbërisë, gjatë shekujve XIV dhe XV e ndante fatin e njëjtë me pjesët tjera etnike arbërore. Ushtria osmane e rrezikonte seriozisht jo vetëm territorin e sotëm të Ballkanit, por edhe gjithë Evropën. Përballë një rreziku të tillë, popullata autoktone arbërore në Kosovën e sotme, si dhe udhëheqësit e saj shpirtërorë, nuk mund të rrinin indiferentë, por u bënë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në rezistencën antiosmane.

Jo vetëm në të kaluarën, por edhe sot hasim botime, të cilat si qëllim kryesor të tyre kanë jo gjurmimin e dëshmimeve historike, por shtrembërimin e së vërtetës historike. Pra, kemi përpjekje që të anashkalohej ose mohohet pjesëmarrja e popullsisë autoktone arbërore në rezistencën antiosmane. Qasje të tilla nuk kanë mbështetje historike dhe, për më tepër, mund të konsiderohen edhe tendencioze dhe qëllimkëqija. Kështu, në radhë të parë kemi mohimin e autoktonisë shqiptare, me mohimin e kulturës dhe organizimit të krishterë, pra duke u munduar që t'i hapin rrugë tendencave të mbrapshta të shqiptarëve të sotëm ishin një popullsi e paorganizuar dhe se ishin lojalë ndaj pushtuesve osmanë. Sipas këtyre autorëve, shqiptarët si bashkëpunëtorë të pushtuesit osman janë sjellë në territorin e Kosovës së sotme në shekullin XVIII. Mirëpo, dokumentet e kohës na dëshmojnë se arbërorët kishin një organizim të mirëfilltë kulturor, religjioz e ushtarak dhe se ishin të parët që korrën fitore ndaj ushtrisë osmane në Gadishullin e sotëm Ballkanik. Medievalisti i mirënjohur kroat, Milan von Šufflay, na sjellë njoftime se në gjysmën e dytë të shekullit XIV, në kohën e shfaqjes së rrezikut osman, në trojet tona arbërore kishim një lulëzim të katolicizmit.<sup>xi</sup> Historia e Mesjetës e cilësuar si *Periudha e Besimit*, ishte një periudhë kur besimi dhe institucionet e saj luanin një rol determinues në jetën e përditshme të qytetarëve.<sup>xi</sup> Një organizim i mirë i kishës ndër arbërorë, pastaj duke shtuar edhe rolin që luajti kisha në periudhën mesjetare në ndërgjegjësimin e popullsisë dhe dashurisë ndaj Perëndisë dhe vendit të tyre, tregon me së miri se pushtuesit e rinj do të hasnin në rezistencën e armatosur të popullatës autoktone arbërore.

Ushtria osmane më 26 shtator 1371, pranë lumit Maricë, te vendi i quajtur Çernomen, arriti fitore kundër ushtrisë së aleancës së krishterë.<sup>xi</sup> Dokumentet e kohës dëshmojnë se popullata arbërore ishin pjesë e aleancës antiosmane.<sup>xi</sup> Pra, osmanët nuk luftuan vetëm kundër serbëve, sikur tentojnë disa autorë<sup>xi</sup> për të shtrembëruar të vërtetën historike. Ky sukses i osmanëve, u dha mundësi që të ndërmerrenin ndonjë ekspeditë më serioze në Ballkanin e sotëm.<sup>xi</sup> Pas Betejës së Maricës, si duket Papatit e kishte të qartë se çka do të thotë depërtimi osman në Ballkanin<sup>xi</sup> e sotëm.

Para një rreziku të tillë, kreu i Kishës Katolike nuk mund të rrinte duarkryq, por i filloi përpjekjet për një organizim më të mirë ushtarak në mbrojtje kundër pushtuesve osmanë. Kështu në shek. XV, Papatit bëri thirrje për luftë të përbashkët kundër turqve<sup>xi</sup> (*osmanëve*, vër.

---

B. M.). Në këtë drejtim, kryepriiftërinjtë e Romës bënë çmos për t'i pajtuar sundimtarët e krishterë dhe për t'i bashkuar në një luftë dhe rezistencë të përbashkët. Vetëm në këtë mënyrë mund të zbrapset rreziku i madh që i kanosej krishterimit dhe perëndimit. Një vit më vonë, në pranverë, Gërguri XI i Avinjoni e thirri mbretin e Hungarisë, Ludvigun dhe dukën e Venedikut që t'i bëjnë ballë forcës osmane dhe ta shporrin nga territoret e pushtuara. Papa e përsëriti edhe një herë ftesën e vet një vit më vonë (1372) duke e zgjeruar tani edhe te perandori grek, te perandori titullar latin, te venedikasit, gjenovasit, kalorësit në Rod si dhe te disa tjerë, por si duket pa sukses. Në këtë kohë, në pjesën më të madhe të Kosovës së sotme sundonte Vuk Brankoviçi, edhe pse në histori nuk është aspak e qartë se prej kur ekziston territori i "zotit" Vuk. Nën administratën e tij përmenden qytetet: Prishtina, Trepça, Vuçitërna, Zveçani, Sjenica. Pak më vonë e zgjeroi territorin e vet, duke ia bashkëngjitur Prizrenin dhe Shkupin me rrethinë, që deri atëherë ishin nën sundimin e mbretit Vukashin.<sup>xi</sup> Por, këtu duhet shtuar se përkatësia etnike e popullsisë, nuk ndërlihet me përkatësinë etnike të sundimtarit, sidomos gjatë periudhës mesjetare, kur sundimtarët ndërroheshin shpesh, por popullsia mbetej ajo që ishte.

Gjithashtu, në territorin e Kosovës së sotme, zotërimet e tyre i kishin shtrirë edhe familjet bujare arbërore, si Balshajt, në qytetin e Prizrenit, Pejës e deri në Kriva Rjekë, pranë Novobërdës, pastaj Kastriotët, prej Rodonit deri në Prizren,<sup>xi</sup> dhe Dukagjinët, në drejtim të Prizrenit, Pejës dhe Gjakovës.<sup>xi</sup>

Shumë sundimtarë të atëhershëm, për t'i zgjidhur problemet e tyre të brendshme, kërkonin ndihmë nga jashtë. Të vetmit osmanlinjtë asokohe kishin një ushtri të përhershme dhe të organizuar mirë. Osmanlinjtë për çdo ndihmë ushtarake që u ofronin, si shpërblym u kërkonin vazalitet dhe disa kushtëzime tjera në luftë dhe në paqe.<sup>xi</sup> Më ndihmën e mercenarëve turq, mbreti bizantin, Androniku III, në vitin 1336 i kishte mundur malësorët shqiptarë.<sup>xi</sup> Toma Preljuboviçi (1381), kishte ftuar turqit që ta ndihmonin në luftë kundër Gjini Bua Shpatës.<sup>xi</sup> Sikur na njofton Kantakuzeni edhe Despoti Niqifor (1358), me stratiotët e tij grekë dhe mercenarë turq, ishte mundur që t'i mundë fisnikët arbërorë, por që kishte mbetur i vrarë, nga ushtritë e tyre që lëviznin shpejt.<sup>xi</sup>

Për ta zhdukur rrezikun që vinte nga osmanlinjtë dhe për ta ndërprerë depërtimin e tyre të mëtejshëm, më 28 qershor 1389 (sipas kalendarit të vjetër më 15 qershor), u bë edhe një përpjekje me luftën e Kosovës, afër Prishtinës, e njohur si Beteja e Kosovës.<sup>xi</sup>

Kjo Betejë nuk kishte karakterin e një ballafaqimi etnik, ku serbët ishin pjesëmarrës dhe humbës të vetëm, sikur pretendohet në historiografinë serbe.<sup>xi</sup> Në këtë çast historik, Lazari, nuk mund të kryente bashkimin e popujve të Ballkanit të sotëm. Ai nuk ishte sovran mbi sundimtarët e tjerë ballkanikë dhe as udhëheqës për të gjithë, madje as për vetë serbët, të cilët ishin të ndarë në disa shtete feudale. Ai u vu në krye të këtij koalicioni vetëm për faktin se agresioni osman ishte drejtuar në këto momente, në radhë të parë, kundër shtetit të tij, siç është shprehur studiuesi Pulaha.<sup>xi</sup>

---

Kronistët osmanë, Bitlisi, Shukrullahu, Aliu, Saddedini etj., njoftojnë se synimi i osmanlinjve në këtë fushatë ishte që të thyenin rezistencën e serbëve, shqiptarëve dhe boshnjakëve.<sup>xi</sup> Pra, sikur shihet, në këtë betejë kemi të bëjmë me një koalicion të popujve ballkanikë, e jo koalicion sllav, sikur është shprehur studiuesi Castellan.<sup>xi</sup> Madje, ushtria osmane në këtë betejë u ndihmua nga serbët e jugut dhe nga bullgarët.<sup>xi</sup>

Sa i përket pjesëmarrjes së shqiptarëve në këtë betejë, kemi mendime kundërthënëse. Për të mohuar kontributin e shqiptarëve në këtë koalicion, duhet cekur se më të angazhuarit janë studiuesit serbë.<sup>xi</sup> Me kalimin e kohës, kjo betejë u kthye në mit, e për këtë meritat i takojnë kishës ortodokse serbe.<sup>xi</sup>

Për serbët, sikur edhe është shprehur studiuesi Malcolm, Beteja e Kosovës është bërë një lloj totemi apo hajmalie për identitetin serb,<sup>xi</sup> duke marrë një rol politik të veçantë antishqiptar,<sup>xi</sup> prandaj edhe kuptohet se cila është arsyeja e shtrembërimit të fakteve historike. Duan të tregojnë se Kosova në mesjetë ka qenë e huaj për shqiptarët.<sup>xi</sup> Sikur shihet, shqiptaret ishin faktorë kyç në Betejën e Kosovës, prandaj mendimi i studiuesit Hasanović se në këtë betejë morën pjesë ... pjesërisht shqiptarët,<sup>xi</sup> nuk ka mbështetje historike.

Studiuesit e huaj të mirënjohur, si Hammeri, Jireçeku, Cvetkova,<sup>xi</sup> Zinkeisen<sup>xi</sup> Uzunçarshëllë, Dyselje,<sup>xi</sup> Almond,<sup>xi</sup> Jacques,<sup>xi</sup> Castellan,<sup>xi</sup> Malcolm,<sup>xi</sup> dhe në mënyrë të veçantë historiografia shqiptare, duke u mbështetur në burimet historike, kanë vërtetuar pjesëmarrjen e shqiptarëve në këtë betejë si dhe karakterin e saj si një aleancë e forcave të bashkuara të popujve ballkanikë kundër vërshimit osman.

Nga e tërë kjo që u cek më lart, mund të shtrohet pyetja se si mund të mohohet pjesëmarrja dhe roli i popullatës autoktone arbërore në Betejën e Kosovës, kur dihet se ajo u zhvillua në truallin e tyre. Si mund të zhvillohet një betejë, ku popullsia vendase të luajë rolin e shikuesit dhe jo të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në fushën e nderit. Në këtë rast duhet theksuar rolin e heroit të betejës, princit nga Kosova e sotme, Milosh Kopiliqit,<sup>xi</sup> më vonë mbiemri u ndryshua në Obiliq,<sup>xi</sup> në fakt ky ndryshim i mbiemrit që bërë për të humbur gjurmët e prejardhjes së tij nga fshati Kopiliq i Drenicës.<sup>xi</sup> Territori i krahinës së Drenicës ndodhet në qendër të territorit të Kosovës, ku gjenden edhe vargmalet e Qyqavicës, ku sipas të gjitha gjasave, ushtria e koalicionit të krishterë është pozicionuar para fillimit të betejës.

Pasi ngadhënjyen në Betejën e Kosovës, osmanlinjtë e përmbysën pavarësinë e Serbisë, Bosnjës, Bullgarisë dhe Arbërisë.<sup>xi</sup>

Princërit dhe feudalët territorialë nuk mbanin vetëm shpurat e tyre të armatosura, por edhe një grup personash civilë, shkruar e klerikë, të cilët përbënin së bashku me disa fisnikë oborret arbërore. Komunikimi me shkrim dhe përfaqësimi diplomatik e ndërmjetësues me princat e tjerë dhe republikat e Raguzës, Venedikut dhe Papatit ishin kryesisht në duart e klerikëve arbëror.<sup>xi</sup> Pas pushtimit të Bosnjës (maj 1463), përfaqësuesit e Papa Piut II mundën ta zhvillojnë me sukses veprimtarinë e tyre diplomatike në Shqipëri (*Arbëri*, vër. B.M), në Venedik e në Hungari.<sup>xi</sup> Aleanca e Venedikut me Shqipërinë (*Arberinë*, vër. B.M), Hungarinë e Burgonjën ngjalli shpresa të mëdha tek Piu II, për të organizuar një kryqëzatë në verën e vitit 1464. Papa kishte zgjedhur Shqipërinë si pikënisje e kryqtarëve, ndërsa komanda e përgjithshme mbi

---

trupat tokësore do t'i besohej Kastriotit.<sup>xi</sup> Edhe ky organizimin dështoi, si pasojë e përçarjeve dhe luftërave në mes mbretërive e princërve të perëndimit të krishterë.<sup>xi</sup>

Perandoria Osmane në këtë kohë e kishte ushtrinë më të organizuar dhe më të pajisur me armatim. Si pasojë e pushtimeve që kishte kryer në vendet e krishtera, ajo kishte futur tmerrin. Për të ndaluar pushtimin e tokave në territorin e Ballkanit të sotëm, duhej një organizim i vërtetë nga strategët ushtarakë, diplomatët dhe predikuesit fetarë. Dështimi i një organizimi të tillë solli pasoja shumë të rënda dhe afatgjata.

Qyteti i Shkupit, në të cilin ndodhej selia e parë ipeshkvore në Dardani,<sup>xi</sup> për të cilin Hijerokli theksonte se ishte metropol i Dardanisë,<sup>xi</sup> me gjithë rezistencën e organizuar, u pushtua nga osmanlinjtë në vitin 1392,<sup>xi</sup> pushtuesit u sollën me mjaft vrazhdësi në shenjë hakmarrjeje për rezistencën e bërë.<sup>xi</sup> Osmanlinjtë e shndërruan këtë qytet në bazë të madhe ushtarake, nga këtu, dërgoheshin ushtritë në drejtim të Bosnës<sup>xi</sup> dhe në veri kah Hungaria.<sup>xi</sup> Kështu ranë dalëngadalë nën kontrollin dhe sundimin turk të gjitha viset tjera arbërore.

Në betejën e Varnës (1444), ushtria e krishterë pësoi disfatë kundër ushtrisë osmane, ku mbetën të vrarë edhe mbreti Ladisllav<sup>xi</sup> dhe kardinali Cezarin.<sup>xi</sup> Kjo disfatë, sikur është shprehur studiuesi Babinger, "duhet t'i ketë dhënë një goditje për vdekje shpresave të Kurisë papnore dhe qëndresës shqiptare".<sup>xi</sup> Sikur shihet, roli i popullsisë arbërore në luftën kundër pushtuesve osmanë, vlerësohej mjaft mirë, sepse roli i tyre ishte vendimtar.

Pas disfatës që pësoi prijësi hungarez, Janosh Huniadi, në betejën e Varnës, në vitin 1446 i filloi planet për një kryqëzatë të re, qëllimi i së cilës që t'u hakmerrej osmanlinjve për disfatën e Varnës. Thirrjes së Huniadit për këtë kryqëzatë iu përgjigj negativisht Republika e Venedikut,<sup>xi</sup> Alfonsi V dhe Gjergj Brankoviqi, që arsyetohej se kishte bërë më parë marrëveshje me sulltanin. Pra, siç shihet, vetëm Skënderbeu që i gatshëm ta ndihmonte këtë ekspeditë. Në verë të vitit 1448, pasi kishte tubuar një ushtri nga repartet hungareze, polake, rumune, çeke dhe të një pretenduesi të fronit osman, Huniadi kaloi Danubin dhe, duke i shkretëruar zotërimet e despotit Gjergj, doli në Kryshevc. Nga këtu, duke kaluar nëpër krahinën e Rashkës, luginën e Toplicës, arriti në Fushë - Kosovë. Me t'u informuar nga legatët e despotit serb për paraqitjen e ushtrisë së krishterë, sulltan Murati II ndërpreu ekspeditën që kishte përgatitur kundër Shqipërisë dhe, duke dhënë një kushtim të përgjithshëm, tuboi në Sofje rreth vetes të gjitha repartet, që i zotëronte në Azi dhe Evropë. Sipas burimeve osmane, ato kishin rreth 50.000 deri 60.000 ushtarë. Mirëpo, nga kronikat perëndimore numri i tyre del i trefishuar. Repartet e aleancës së krishterë, sipas burimeve Perëndimore, arrinin 22.000 deri në 72.000 ushtarë, ndërsa sipas burimeve turke 24.000 ushtarë. Derisa Huniadi i afrohej Fushë - Kosovës, mejdan i vjetër i vitit 1389, sulltan Murati II ishte nisur nga Sofja dhe i doli në pritë.<sup>xi</sup> Kjo betejë, e cila u zhvillua tri ditë, nga data 17-19 tetor 1448,<sup>xi</sup> përfundoi me disfatën e plotë të ushtrisë së krishterë.<sup>xi</sup> Si shkaku kryesor i vonësës së prijësit shqiptar për t'i ndihmuar aleatit të tij, Huniadit, konsiderohet pothuaj unanimitisht, se Skënderbeu që i penguar prej despotit serb, Gjergj Brankoviqit,<sup>xi</sup> aleat i dhëndrit dhe sovran i vetë Muratit II, i cili ia mbylli këtij të gjitha rrugët e shtigjet nga mund të kalonte.<sup>xi</sup> Argumentet e cekura, hedhin poshtë mendimi se

---

serbët, edhe pas Betejës së Kosovës vazhduan luftën kundër pushtuesve osmanë edhe për një kohë të gjatë, së bashku me miqtë e tyre hungarezë.<sup>xi</sup> Gjithashtu, këto argumente flasin për vazhdimësinë e qëndresës së armatosur të popullsisë arbërore - shqiptare kundër pushtuesve osmanë dhe bashkëpunimin që kishin me udhëheqësit perëndimorë.

Kontributi i klerit në diplomacinë e Skënderbeut ishte aq i madh sa që, pranë rolit të shkëlqyeshëm të klerikëve, roli i laikëve, ndonëse nuk mungon, duket pak më i zbehur.<sup>xi</sup>

Novobërda, me potencialin e madh ekonomik ishte një nga qytetet më të pasura në Ballkan. Mbi jetën fetare dhe organizimin kishtar në këtë qytet, ka të ruajtura shumë me tepër shënime se në famullitë e tjera në Kosovë gjatë mesjetës. Këtë e mundësoi zhvillimi ekonomik e kulturor dhe marrëdhëniet tregtare me vendet e tjera. Nga ky qytet dolën emra të shquar, jo vetëm të kishës papnore, por edhe burra të ditur në lëmenj të shkencës, letërsisë dhe arteve figurative. Në këtë qytet të madh ekzistonte Katedralja Katolike, kushtuar pajtorit të këtij qyteti, *Shën Nikollës*, pastaj kisha e Zojës Mari.<sup>xi</sup> Është e ditur se Kisha e Shënkollit ishte mjaft e pasur si dhe e pajisur plotësisht me të gjitha mjetet kishtarë dhe me libra meshimi.<sup>xi</sup> Qyteti i Novobërdës, disa herë ishte objekt i sulmeve osmane, në vitin 1412, 1440-1441, kur pas rrethimit të gjatë u pushtua përkohësisht, dhe së fundi, në vitin 1454, kur sulltan Mehmeti II rrethoi qytetin dhe pas bombardimit me topa të mëdhenj, e pushtoi me 1 qershor 1455.<sup>xi</sup> Rënia e qytetit la mbresa të mëdha në Hungari, në Itali e në Dalmaci, meqë Novobërda, konsiderohej një ndër qendrat kryesore për mbrojtjen e krishterimit.<sup>xi</sup> Mendimi se më rënien e Novobërdës nën sundimin osman, fillon edhe pastrimi etnik i serbëve nga Kosova,<sup>xi</sup> nuk është i arsyeshëm, kur dihet se serbët kishin pranuar vazalitetin osman, prandaj osmanët nuk kishin asnjë arsye për ta luftuar apo larguar popullatën serbe nga territori i sotëm i Kosovës.

Pas Novobërdës, ranë edhe qytetet tjera të cilat disi qenë mbajtur deri atëherë. Qyteti i Prizrenit u pushtua në vitin 1458, pas tij edhe Lipjani. Vuçiterna u pushtua përfundimisht në vitin 1454, Peja në vitin 1462. Vetë fakti se qytetet, të cilat ishin të fortifikuara dhe që në kuadër të tyre kishin edhe kishat e tyre katolike dhe rezistenca kundër pushtuesve osman ishte shumë më mirë e organizuar, tregon qartë rolin që ka luajtur Kisha Katolike në territorin e Kosovës së sotme në mbrojtjen e vendit e të dinjitetit njerëzor.

Priftërinjtë katolikë shqiptarë, si në luftën e armatosur, ashtu edhe në kryengritjet që pasuan më vonë, qenë dhe mbetën aktivë në rezistencën antiosmane gjatë gjithë periudhës sa zgjati ky pushtim. Si pasojë e dhunës së ushtruar nga ana e pushtuesve osmanë, bashkë me besimtarët, kishin pësuar edhe udhëheqësit e tyre shpirtërorë, të cilët u martirizuan. Kështu urdhërat kishtarë, si ai i benediktinëve dhe i dominikanëve, të cilët me parë ishin shtyllë e Kishës Katolike ndër shqiptarë, u shuan. Kuvendet e tyre, të cilat më herët qenë dëshmi e lulëzimit të katolicizmit, tani u bënë gërmadha. Vetëm françeskanët mbetën në këtë trevë, duke i përjetuar vuajtjet dhe ndjekjet e shumta dhe të përgjakshme të Kishës.<sup>xi</sup> Roli i françeskanëve ishte shumë i rëndësishëm për ruajtjen e katolicizmit në kohën osmane.<sup>xi</sup>

Bazuar në burimet e mirëfillta shkencore, mund të themi se territori i Kosovës së sotme dhe popullsia autoktone arbërore, qenë pjesë e pandarë e territoreve arbërore, si në aspektin etnik, kulturor dhe shpirtëror. Gjithashtu, edhe Kisha Katolike në territorin e Kosovës së

---

sotme, së bashku me institucionet dhe besimtarët e saj, qenë pjesë e përbashkët e territorit arbëror. Kështu, të gjitha iniciativat e ndërmarra, si nga Papati, ashtu edhe nga ana e prijësve evropianë në rezistencën kundër osmanëve, konkretisht në territoret arbërore, ishin të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me krerët, prijësit dhe me përfaqësuesit e Kishës Katolike që vepronin në territoret arbërore. Përpjekjet për të mohuar rolin e Kishës Katolike në rezistencën kundër osmanëve, kanë qëllim që të mohojnë autoktoninë e popullit shqiptar në Kosovë si dhe kontinuitetin dhe lidhjen me kulturën perëndimore - evropiane.